

V E N D I M
Nr. 568, datë 23.10.2000

**PËR KALIMIN NË VARËSI TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TË
OBJEKTEVE “MONUMENT KULTURE”, NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË
MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994, “Për mbojtjen e pasurisë kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të gjitha objektet e shpallura “Monument Kulture”, që ndodhen brenda territorit të objekteve apo reparteve ushtarake, në çastin e shkrirjes, të transferimit apo të ndërprerjes së veprimtarisë së këtyre të fundit, kalojnë, menjëherë, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Këto objekte përjashtohen nga procedura e përcaktuar me vendimin nr.153, datë 3.4.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e objekteve e të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve e të institucioneve shtetërore”.

3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, t’i dorëzojë Ministrisë së Mbrojtjes listën e plotë të objekteve “Monument Kulture”, të cilat ndodhen brenda zonave apo reparteve ushtarake.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Mbrojtjes, që, në zbatim të këtij vendimi, të nxjerrin aktet e nevojshme, për ruajtjen dhe administrimin e këtyre objekteve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta